



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:243734
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05745583

PA1.nr.708/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Skender Çoçaj - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. M., nga V, për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia, nga neni 410 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtëses së të akuzuarit A. M.-avokat A. I., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.825/2021, datë 22.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses së të akuzuarit A. M.-avokat A. I., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.825/2021, datë 22.03.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.825/21, 22.03.2024, të akuzuarin A. M. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Vetëgjyqësia, nga neni 410 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, dhe për veprën penale nga dispozitivi I të këtij aktgjykimi, i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 1.000.00 (njëmijë) euro, ndërsa për veprën penale nga dispozitivi II të këtij aktgjykimi, dënim me gjobë në lartësi prej 1.000.00 (njëmijë) euro. Pas unifikimit të dënimit, në kuptim të nenit 76 par. 1 dhe 2 nën par 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqipton dënim unik me gjobë shumë në lartësi

prej 2.000,00 (dymijë) euro, e të cilin dënim i njëjti është obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej 20 (njëzetë) euro për një ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguaje gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet. I akuzuari është obliguar që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor shumen prej 50 (pesëdhjetë) euro, dhe shumen në lartësi prej 20 (njëzet) euro ne emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit. I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit A. M.-avokat A. I. për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, të akuzuarin të i shqiptoj dënim më të ulët me gjobë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.710/24, të datës 10.05.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se:

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimin të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë më rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ka marrë si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë së të akuzuarit

dhe jo të tjera, ndërsa si rrethana rënduese ka gjetur se i akuzuari ka kryer dy vepra penale ndaj viktimës së njëjtë dhe se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare, pra nuk mori parasysh një mori të rrethanave lehtësuese si faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, i njëjti nuk ka punë të rregullt por vetëm punon herë pas here, i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë gjykimi, asnjëherë më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, keqardhjen e shfaqur dhe sjelljen e tij pas konfliktit. Duke marrë parasysh faktet lartcekura, mbrojtja konsideron se dënimi me gjobë është tejet i lartë, ashtu që pamundësia e pagesës së gjobës nga i akuzuari do të çonte në zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me burgim, e cila do të krijonte një gjendje të rënduar në familjen e tij. Pra, gjykata nuk ka peshuar mirë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese, duke i mbi peshuar ato rënduese e kështu duke shqiptuar dënim tejet të ashpër i cili nuk është në harmoni me peshën e veprës penale, dhe se ky dënim i shqiptuar tejkalon edhe qëllimin e dënimit i cili përcaktohet me dispozitën e nenit 69 par. 2 të KPRK-së më të cilën dispozitë shprehimisht thuhet se “dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës, sjelljen dhe rrethanat e kryesit”. Nga të gjitha këto propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit A. M. të i shqiptohet dënim më i ulët me gjobë.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtëses së të akuzuarit, për shqiptimin e dënim më të ulët me gjobë ndaj të akuzuarit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte për shqiptimin e dënim më të ulët me gjobë, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka pranuar fajësinë, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret gjeti se i pandehuri ka kryer dy vepra penale ndaj viktimës së njëjtë, e po ashtu se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t’i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më të ulët me gjobë, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë

dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi e saj. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.708/24, më datë 27.05.2024

Zyrtarja ligjore;
Rrezarta Bala

Kryetari i kolegjit
Abdullah Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:
Ferit Osmani

Skender Çoçaj